



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 13.11.2018 dhe 14.11.2018.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për përfundimin e proceseve tranzitore në Republikën e Shqipërisë” (*Komision përgjegjës*)
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Tom Doshi dhe Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Teuta Vodo - Zëvendësministre e Drejtësisë
Artan Lame - Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale

Enis Hoxha – Zëvendëskryerregjistruer në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajts

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 13 dhe 14 nëntor 2018. A ka vërejtje nga kolegët për procesverbalet e këtyre dy mbledhjeve? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit për datat 13 dhe 14 nëntor 2018.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës shqyrtimin në parim të projektligjit “Për përfundimin e proceseve tranzitore në Republikën e Shqipërisë” nismë e Këshillit të Ministrave. Komisioni ynë në shqyrtimin e kësaj nisme është komision përgjegjës dhe relator për këtë nismë janë kolegët Klotilda Bushka dhe Bashkim Fino. Duke qenë se të dy projektligjet kanë lidhje me njëri-tjetrin, si pikë të tretë kemi përsëri shqyrtimin në parim të projektligjit “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”, edhe kjo nismë e Këshillit të Ministrave. Edhe për këtë projektligj komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relator për këtë projektligj janë Klotilda Bushka dhe Bashkim Fino.

Dua të sjell në vëmendjen e komisionit se kemi edhe dy çështje të tjera në rendin e ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”, nismë e deputetit Erion Braçe, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171, të vitit 2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”, edhe ky projektligj nismë e deputetit Erion Braçe.

Gjithashtu, dua të sjell në vëmendjen e komisionit se të dyja nismat e deputetit Erion Braçe janë prezantuar në këtë komision nga kolegu ynë Braçe, por ka një vendimmarrje të komisionit që këto dy nisma të bashkohen. Pra, duke qenë se adresojnë një problematikë të caktuar që ka lidhje me përfundimin e procesit tranzitor në Republikën e Shqipërisë dhe me ligjin për kadastrën në Republikën e Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve vendosi që këto dy nisma të bashkohen me dy nismat e sjella sot nga qeveria dhe këtu dua të falënderoj qeverinë për gatishmërinë e treguar,

sepse u tha që brenda muajit nëntor të do vinin nismat, të cilat do të bashkohen me nismat e deputetit Braçe për t'i adresuar një herë e mirë të gjitha problematikat.

Sot, ne do të prezantojmë dhe do të miratojmë në parim vetëm dy nismat që ka sjellë qeveria dhe më pas në një mbledhje të radhës do të vazhdojmë me shqyrtimin dhe me miratimin nen për nen të këtyre dy nismave.

Vazhdojmë me projektligjin e parë “Për përfundimin e proceseve tranzitore në Republikën e Shqipërisë”. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zonja Teuta Vodo, zëvendësministre.

Mirë se keni ardhur zonja Vodo!

Nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, zoti Artan Lame.

Mirë se erdhët, zoti Lame!

Nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zoti Enis Hoxha, zëvendëskryereregjistrues.

Nuk e di se kush do ta bëjë prezantimin e këtyre dy projektligjeve. Kush e do fjalën për të bërë prezantimin zonja Vodo apo zoti Lame?

Fjalën e ka zonja Vodo, zëvendësministre e Drejtësisë.

Teuta Vodo – Përshëndetje!

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 201, datë 21.11.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të posaçëm të punës për riorganizimin e institucioneve të varësisë dhe rishikimin e kuadrit ligjor”, është ngritur grupi i punës i kryesuar nga drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, ALUIZNI-t, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, si dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronës.

Në ushtrim të të drejtave dhe detyrave të ngarkuara grupi i punës vlerësoi në tërësi situatën me lëshimin dhe regjistrimin e titujve të pronësisë, kuadrin ligjor dhe organizimin funksional për institucionet qendrore dhe vendore që zhvillojnë aktivitet në fushën e së drejtës së pronës. Vizioni i nismës është pasja e një sistemi të konsoliduar të titujve të pronësisë, që nënkupton se çdo pronë të jetë e regjistruar, të jetë e pasqyruar saktë dhe të ketë një pronar të identifikueshëm. Linjat e përgjithshme dhe parimet orientuese që do të mbështeten te reforma janë: deburokratizimi dhe

deregulimi. Pra, nga mekanizmi aktual ligjor do të eliminohet çdo hallkë e panevojshme që shkakton, nënkupton shkurtimin e procedurave dhe të dokumentacionit që shoqëron procesin administrativ, duke lehtësuar kështu barrën burokratike që rëndon mbi subjektet e interesuara, pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme.

Pika e dytë, trajtimi sistematik. Pra, proceset e ndryshme të lidhura me pronën, legalizim, azhurnim, trajtim prone, regjistrim MP-je, inventarizim i pronave shtetërore do të konceptohen dhe zbatohen në mënyrë të njëkohshme dhe sistematike. Proaktiviteti, pra shteti për çështje që kanë të bëjnë me pronën duhet të ketë efektivisht rolin e rregullatorit, jo thjesht të konstatuesit apo vrojtuesit të problematikave.

Pika e mëposhtme, unifikimi i bazës hartografike dhe dixhitalizimi i funksionalizimit i të gjitha proceseve që lidhen me pasuritë e paluajtshme, çka përbën edhe një nga kushtet themelore për të mundësuar realizimin e reformës, dixhitalizimin e sistemit të pasurive të paluajtshme, si dhe të të gjitha proceseve të tjera administrative të lidhura me pronësinë.

Ndërhyrja e reformës do të prekë proceset kryesore si vijojnë: mbylljen e proceseve tranzitore të pronësisë, përfshirë regjistrimin fillestar të pronarëve ligjorë sipas AMTP-ve, leje legalizimi, vendimet për trajtimin e pronës dhe pronarëve faktikë, procesin e përmirësimit dhe përditësimit të pronarëve të zonave kadastrale, meqenëse edhe informacioni i regjistruar për pjesën më të madhe të tyre është totalisht në gjendje manuale, i papërmirësuar, i papërditësuar për një periudhë 20-vjeçare, pavarësisht karakterit dinamik që ka prona. Ndërveprim i drejtpërdrejtë së brendshmi midis institucioneve që gjithashtu do të rezultojnë në akte pronësie. Riorganizimi i institucioneve të pronësisë do të kryhet duke u bazuar më mirintegrimin e secilit prej këtyre proceseve, sot e ndarë në më shumë institucione në një institucion të vetëm, pra Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në përmbajtje të institucionit të ri do të operojnë departamente të veçanta, duke u mundësuar atyre autonomi të brendshme, si dhe do të synojmë të organizohen sipas funksioneve prioritare për kryerjen e proceseve tranzitore, ku përfshihen regjistrimi fillestar, përmirësimi dhe përditësimi i ndërtimeve pa leje. Reforma institucionale parashikon të krijojë një platformë të dedikuar, pra një strukturë të posaçme apelimi për trajtimin e ankesave të qytetarëve me qëllim përmirësimin e shërbimit fundor për qytetarët, por edhe në përmirësimin e proceseve dhe të funksioneve të vetë institucionit. Ky informim strukturor garanton koordinimin më të mirë ndërmjet proceseve të veçanta, çka është karakteristikë e sistemeve të centralizuara. Gjithashtu,

me këtë organizim zgjidhet një problem themelor, ai me të cilin organet shtetërore lëshojnë tituj pronësie konkurrojnë në trajtimin e të njëjtës pronë me procedura të veçanta, me subjekte të ndryshme dhe pa e bashkërenduar informacionin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Vodo!

Zoti Lame, ju lutem, një prezantim më të detajuar të këtij projektligji!

Artan Lame – Faleminderit!

Do të doja t'ju thosha dy fjalë nga pikëpamja historike se si u arrit deri këtu, kjo ka të bëjë jo nga pikëpamja historike me Shqipërinë, megjithëse edhe për atë do të kishte vend për të folur. Problematika e çështjeve të pronësisë është mëse e njohur, prandaj është e kotë të flasim gjerë e gjatë për situatën e rënduar në gjithë fushën e pronësisë në vend.

Elementi i parë që na bëri të viheshim në lëvizje ishte krijimi i një grupi pune nga ana e Kryeministrit, vjet në nëntor, i cili kishte për qëllim pikërisht këtë gjë, adresimin e gjithë problematikave dhe t'u jepte rrugëzgjidhje. Ndërkohë që grupi i punës po punonte, ne u ndeshëm edhe me një analizë të bërë nga ana e Bankës Botërore për çështjet e pronësisë. Ishte kënaqësi për ne që përgjithësisht përfundimet e arritura nga ky grup pune ishin të njëjta me analizën e bërë nga Banka Botërore.

Pra, e thënë me dy fjalë, ishte kaos institucional i trashëguar, kaos të dhënash, shumë institucione me shumë baza të dhënash të paintegruara me njëra-tjetrën dhe kaos ligjor, ligje të veçanta edhe ato të paintegruara me njëri-tjetrin. Thelbi i problemit që na bëri të shkonim drejt titullit që është zgjedhur për ligjin, përfundimi i proceseve kalimtare të pronësisë, ka të bëjë me faktin që në '90-tën u nisëm të hapnim disa procese që duhej të rezultonin si të përkohshme pronësimi. Pra, në '90-tën ndryshuam sistemin dhe gjithë pronën që ishte pronë-shtet duhej t'ua kalonim qytetarëve në një mënyrë apo në një tjetër. Këto procese që duhej të bënin kalimin e pronës nga shteti te qytetarët u nisën si procese të përkohshme, ku secili prej tyre duhej të kishte avancuar 2 vjet, por për fat të keq një pjesë e tyre vazhdojnë të operojnë edhe sot, më tepër se çerek shekulli. Mjafton t'ju them se procesi i kthimit dhe i kompensimit të pronave ka filluar në vitin 1993, jemi në vitin 2018, ku sapo kemi bërë një ligj të ri për pronat, i cili adreson problematikat, të cilat nuk i mbylli dot asnjë nga ligjet paraardhëse. Procesi i ndarjes së tokës në fshat i nisur në '91-shin, një proces që e nisi e gjithë Europa Lindore, por e mbylli brenda 2-3vjetësh, vazhdon ende në 2018-ën, ende ndajmë toka në fshat. Procesi i privatizimit të banesave dhe i kalimit të tyre

te qytetarët i nisur në 1992, jemi në 2018-ën dhe ende rezultojnë me mijëra banesa që ende nuk kanë marrë truallin ose nuk kanë përfunduar procesin e regjistrimit të truallit, të banesës së tyre e kështu me radhë.

Procesi i legalizimeve, po e njëjta histori. Një proces që ka filluar që në vitin 1992-1993, i trajtuar me një ligj në vitin 2005 për herë të parë në kohën e qeverisë “Nano”. Jemi në 2018-ën dhe ky proces ende nuk është mbyllur, plus disa procese të tjera të këtij lloji, pra, procese të përkohshme që duhej të kishin mbaruar brenda 2-3 vjetësh, por që janë kthyer në të përjetshme. Ligji merr përsipër t’i trajtojë në bllok të gjitha këto procese për t’i mbyllur një herë e mirë të gjitha proceset tranzitore të pronësimit në Shqipëri. Pas përmbylljes së këtyre proceseve nuk do të ketë më shtet-pronar që vazhdon të ndajë prona, por do të ketë shtet-supervizor, që sheh vetëm transaksionet se si zhvillohen midis qytetarëve apo midis qytetarëve dhe shtetit e kështu me radhë. Ka pasur një shqetësim, ka dalë edhe nga diskutimet në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, por edhe nga opinioni publik kur është diskutuar për ligjet, sikur bëhet fjalë për një ngjitje artificiale të disa institucioneve me njëri-tjetrin. Kjo ka të bëjë me një nga problemet thelbësore, që ka pasur historia e pronësimit në Shqipëri, që do të thotë shumë institucione, të cilat diku për të mos u ngatërruar me tjetrin, diku për të vepruar dhe operuar në mënyrë të pavarur nga institucione të tjera, edhe kur legjislacioni i tyre në nisje ka qenë pozitiv, rrugës është mbingarkuar me aq shumë shtesa dhe ndryshime që kanë krijuar kështjellëza dhe pashallëqe të vogla të palidhura me njëra-tjetrën, por që për fat të keq prodhojnë tituj pronësie apo dokumente pronësie, të cilat, kur vjen puna për t’u regjistruar në ZRPP në hipotekë, krijojnë mbivendosje të njëra - tjetrës.

Përfundimi ynë dhe ai i institucioneve ndërkombëtare ishte që rruga më e thjeshtë është bashkimi i këtyre institucioneve, një pjesë prej tyre tashmë e kanë kryer rolin e vet në këto 20 e ca vjet, dhe në fund të këtij udhëtimi duhet të kemi një institucion që do të mbetet në këmbë, që është kadastra. Të gjitha të tjerat do të shkojnë drejt shuarjes, duke qenë se janë procese që po shkojnë drejt mbylljes.

Mund ta konsiderojmë që reforma aktuale në fushën e pronësisë është reforma më e rëndësishme e kryer në këtë vend, jo vetëm në këta 25 vjet, por ndoshta në gjithë historinë e shtetit shqiptar, do të jetë reforma përmbyllëse për problematikat e pronësisë. Për fat të keq, jemi i vetmi vend në Europë që ende nuk kemi regjistruar pronën, pa shkuar më tej se e kujt është prona, që do të thotë se vet njësitë vendore nuk kanë të regjistruar pronat e tyre, vet shteti nuk ka të regjistruar pronën e vet, vet pronat e qytetarëve në masë të konsiderueshme janë të paregjistruara, pa shkuar

te problematika e mbivendosjes së pronave, që është procesi fillestar i nisur në vitin 1994 i regjistrimit të pronave të paluajtshme, jemi në vitin 2018 edhe ky proces nuk ka përfunduar ende.

Meqenëse u hap diskutimi i bashkimit të institucioneve, u diskutua gjatë se cilat do të jenë ato që do të shkrihen me njëra tjetrën, boshti i sistemit do të mbetet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha institucionet e tjera janë institucione të përkohshme, Agjencia e Trajtimit të Pronës, ALUIZNI, edhe agjencitë shtetërore që merren me regjistrimin e pronës në shtet janë institucione të përkohshme, që një ditë, në të ardhmen, duhet të përfundojnë funksionin e tyre. Boshti i këtij bashkimi është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ai që ne e quajmë Kadastra e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha institucionet e tjera, njëra pas tjetrës, do të shkojnë drejt shuarjes.

Në këtë kuadër, ideja fillestare ishte shkrija e të gjitha institucioneve. Në një fazë të parë u la mënjanë Agjencia e Trajtimit të Pronës për një arsye më shumë taktike sesa strategjike. Kjo agjenci ka bërë një punë të jashtëzakonshme në këta 4 vjet mbi bazën e ligjit të ri që u miratua dhe procesit të rivlerësimit të vendimmarrjes së marrë në këta 20 e ca vjet dhe hedhjes së saj në një hartë të përbashkët, por nga ana tjetër, po gjendet përballë vendimmarrjes në Gjykatën e Strasburgut. Do të ishte mirë që të mos krijonim stres dhe idenë që sërish qeveria po ndryshon legjislacionin që ka lidhje me pronën pa filluar të stabilizohet vendimmarrja në Strasburg me ligjin që kanë dhe në një moment të dytë, në të ardhmen, natyrshëm dhe logjikshëm edhe ajo agjenci do të shkrihet në këtë agjenci të re.

Agjencia e ALUIZNI-t, natyrisht që është e para që duhet të përfshihet, sepse ka një proces të legalizimeve në rrugën e përfundimit. Për sa mund të duket absurde, shteti shqiptar është jashtëzakonisht mbrapa, por në limitet e 3, 4 % për regjistrimin e pronës së vetë dhe të pronës së njësisive vendore dhe për këtë ka një agjenci që ka mbi 10 vjet që funksionon për regjistrimin dhe transferimin e pronës pranë njësisive vendore edhe ajo agjenci shkrihet në këtë agjenci me vullnetin që shteti nuk mundet t'u kërkojë qytetarëve të regjistrojnë pronën, kur vetë ai nuk ka regjistruar pronën e vetë. Është absurde që shteti shqiptar ka të regjistruar rreth 4% të pronës së vet, që do të thotë se pak a shumë në hipotekë ka të regjistruar vetëm pronën e trashëguar nga koha e monarkisë, gjithë të tjerat janë në administrim, përgjegjësi, të kaluar me VKM, por ama po të shkosh në hipotekë, janë të paregjistruara në emër të institucionit. Kjo ka qenë një nga problemet më të mëdha që ka çuar në abuzimin me pronën në shtet. Po ju jap një shembull të thjeshtë në mënyrë që të mund të bëhet paralelizmi me çdo lloj institucioni tjetër: në momentin që prona e një shkolle në

ZRPP figuron si pronë në shtet, por e paregjistruar në emër të Ministrisë së Arsimit ose në emër të shkollës, atëherë ajo është subjekt i çdo lloj grabitjeje pozitive apo negative, me qëllim të mirë apo të keq, jo po do t'i kthehet pronarit, jo po do të legalizohet, jo po do të privatizohet e kështu me radhë, sepse konsiderohet thjesht pronë në shtet. Në momentin që ajo do të figuronte e regjistruar si pronë e Ministrisë së Arsimit, ajo do të ishte e paprekshme nga çdo lloj dëmtimi. Kështu që për fat të keq, detyrohem të them se diku me qëllim, diku paqëllim, e diku për paaftësi të administratës, jemi në nivelet e 4% të regjistrimit të pronës në shtet në këta 10 vjet që ekziston kjo agjenci, e cila edhe ajo bashkohet këtu.

Sfida më e madhe, besoj unë për këtë mandat, në fushën e regjistrimit të pasurive do të mbetet regjistrimi i AMTP-ve, që do të thotë se në Republikën e Shqipërisë rreth 438 mijë familje shqiptare në fshat kanë marrë tokën, kanë dokumentin e marrjes së tokës, por vetëm gjysma e tyre e ka të regjistruar në ZRPP, që do të thotë se gjysma e familjeve shqiptare nuk bëjnë dot transaksione me pronën e tyre në fshat për shkak të mosregjistrimit në kadastër. Është sfida më e madhe në funksion të përmirësimit të situatës pronësore në fshatin shqiptar, e lidhur pastaj me të gjitha transaksionet e mundshme që mund të pësojë toka në fshat, që mund ta shesë, ta blejë, ta japë me qira, mund ta përdorë si kolateral në bankë, ajo që është më e rëndësishmja, mund ta përdorë për të përfituar të gjitha incentivat nga Ministria e Bujqësisë, ku kushti i parë për të përfituar është të kërkojë dokumentin e pronësisë, të cilin ai nuk e ka e kështu me radhë.

Janë edhe disa sektorë të tjerë dytësorë kur i sheh në makro në raport me shifrat e tjerë, por që për çdo qytetar, në fund të fundit, janë problem i rëndë, siç është procesi i regjistrimit të banesave në Republikën e Shqipërisë, i cili ka filluar për herë të parë në vitin 1995 dhe jemi në vitin 2018, ku para disa muajsh qeveria nxori një vendim tjetër, nr. 442 “Për regjistrimin e banesave të viteve para ’91-it” dhe me një masë afrofe duhet të jenë rreth 40 mijë banesa ende të paregjistruara, por që për fat të keq kanë edhe problematika jo të lehta dokumentare për të arritur te momenti i regjistrimit. Është procesi i dhënies së tokës për objektet e privatizuara, që do të thotë se ka një mori objektivash për të cilat shteti ka bërë privatizimin, në shumë raste prej 20 vjetësh dhe ende nuk u ka kaluar truallin në pronësi. Pra, pak a shumë, kjo është moria e proceseve të përkohshme, të cilat duhen të mbyllen me këtë ligj. Në projektligj ka një dispozitë të veçantë për të lënë një shteg të hapur për proceset e tjera që lindin gjatë eksperiencës së punës, sepse ka ende në ikje, ka ende grupime diku më të vogla, diku më të rëndësishme, qytetarë, të cilët kanë probleme të pazgjdhura për regjistrimin pronës.

Mjafton të kujtoj një problematikë të lindur në Sarandë, por që u interesonte shumë zonave të tjera të Shqipërisë para disa muajsh, të cilën jemi duke e trajtuar dhe hartuar paraprakisht përmes një VKM-je, e cila do të dalë në zbatim të këtij ligji për rastet kur bashkitë kanë bërë shitje të trojeve, që nuk i kishin të tyret, por ua kanë shitur qytetarëve, qytetarët janë gjendur me një titull trualli, kanë ndërtuar mbi ato troje dhe sot nuk i regjistrojnë dot, sepse ka dalë që shitja ka qenë e paligjshme. Këtë problematikë e kemi adresuar dhe e futëm në projektligj në bashkëpunim edhe me deputetët e zonës, të cilët ishin të parët që e adresuan fillimisht. Jam i bindur që rast pas rasti, kanë për të dalë edhe nike të tjera të harruara, njerëz të harruar, me të cilët nuk është marrë kurrë njeri.

Do të thosha edhe një fjalë të fundit te problematikat e përgjithshme për situatën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nga pikëpamja e regjistrimit dhe hartografisë.

Ulsi Manja – Më falni, nëse nuk keni diçka për të shtuar për projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”...

Po, mund të vazhdoni!

Artan Lame - Faleminderit!

Shqipëria ka rreth 4.4 milionë pasuri. Nga këto, rreth 3.8 milionë janë regjistruar për herë të parë dhe figurojnë rreth 600 mijë pasuri ende të paregjistruara. Pra, për një vend kaq të vogël siç është Shqipëria, edhe pse procesi i regjistrimit fillestar ka filluar në vitin 1994, tashmë në vitin 2018 ka ende 600 mijë pasuri të regjistruara për herë të parë. Fatkeqësia e madhe është që edhe pasuritë e regjistruara, pra, 3.8 milionë të regjistruara, rreth 80 % e tyre kanë probleme në regjistrim, që do të thotë se ose duhen reregjistruar, ose duhet të bëhet të paktën një rifreskim dhe përmirësim i tyre. Edhe ky është një proces i përkohshëm, dhe duhet trajtuar si i tillë, që duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur. Natyrisht që do të kërkojë vitet e veta, por është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse është ai që ka gjeneruar edhe shumicën e të gjithë problematikës gjyqësore në vend. Pronat përballen dhe përplasen me njëra-tjetrën edhe kur shkojnë në hipotekë, kjo e fundit e ka hartografinë me probleme, gjë që shkakton mbivendosje dhe gjithë atë krizë dokumentare në ZRPP.

Kjo është pak a shumë panorama e problematikave të proceseve të përkohshme. Cili është thelbi i ligjit përtej bashkimit të institucioneve? Thelbi është thjeshtim absolut i procedurave, pra për sa kohë që kemi qytetarë që kanë 10, 20, 30 apo 60 vjet që e gëzojnë atë pronë, është absurde që shteti shqiptar u kërkon dokumentacion të pafund, ndoshta dokumentacion që kishte sens para

20 vjetësh, por është totalisht pa sens në situatën aktuale. VKM-ja që doli në korrik për regjistrimin e banesave të para '91-it, bën fjalë për regjistrimin e banesave të ndërtuara që në kohën e Turqisë, pra ende janë të paregjistruara në ZRPP dhe banorët e kanë gati të pamundur të prodhojnë dokumentacion për të provuar me dokumentacion faktin e pronësisë së tyre. Kjo mbetet një nga pikat kyçe për përmirësimin e sistemit. Pra, thjeshtësimi administrativ sa të jetë e mundur. E njëjta gjë ndodh me regjistrimin e AMTP-ve, gjithë legjislacioni i sotëm, që ka njëzet e pesë vjet për regjistrimin e AMTP-ve, që ndryshon kohë pas kohe legjislacion, ligje, VKM, udhëzime e kështu me radhë, në 2018-ën kërkojnë akoma gjendjen e familje kooperativiste në 1991-shin. Praktikisht, në shumë raste, dokumentacioni është inekzistent, në një kohë që kishte sens të kërkoje më 1991.

Pra, të gjitha këto janë elemente që çojnë në thjeshtimin e dokumentacionit, një nga pikat që e bën operativ.

E dyta, meqenëse kemi të bëjmë me një institucion operues, do të jetë brenda institucionit zgjidhja e gjithë historisë së marrjes së konfirmimeve nga institucione të ndryshme. Sot, për të marrë një AMTP, një fermer duhet të kalojë, për këtë kemi bërë një tabelë, duhet të kalojë njëzet e tre hallka të ndryshme, për të arritur deri te prodhimi i AMTP-së. Praktikisht, kur arrin te gjysma e këtyre njëzet e tre hallkave, atij i ka skaduar gjysma e letrave që ka marrë, kështu që i thuhet të fillojë edhe një herë nga e para. Kjo për shkak të shumë dokumenteve që i duhet të prodhojë, si dhe për shkak të konfirmimit nga shumë institucioneve: konfirmim nga ALUIZNI, konfirmim nga Kthimi i Pronave etj. Sikur njëri nga këto institucione të vonohet, bën që të digjet afati i një dokumenti tjetër.

Pra, duke qenë brenda të njëjtit kuadër ligjor dhe brenda të njëjtit institucion, zhduket e gjithë xhiroja e dokumenteve nga një institucion në tjetrin.

Hapi tjetër i rëndësishëm nga pikëpamja e përgjithshme e legjislacionit, ka të bëjë me shmangien e të gjitha barrierave burokratike, që edhe kur arrinin të prodhoheshin, kishin humbur sensin praktik. Pra, institucione, që prodhonin dokumente, duke e ditur edhe vetë se nuk duheshin më, që nuk ishin më të nevojshme.

Pak a shumë, kjo është skema e përgjithshme e risive të ligjit.

Së fundi, do të shtoja edhe diçka: ligji tenton që çdo proces nuk mbyllet në një ditë. Nëse do të bëja një parashikim nga vetja, procesi i parë që parashikohet të mbyllet është procesi i legalizimeve. Pra, brenda këtij ligji, që ka të gjitha proceset, procesi i parë që do të mbyllet është ai i legalizimit, për shkak të avancimit dhe për shkak të pjesës së limituar të mbetur. Procesi i

fundit që do të mbetet, ka për të qenë procesi i kompensimit të pronës, të cilit edhe vetë ligji për trajtimin e pronës parashikon t'i japë një hapësirë dhjetëvjeçare.

Në fund të të gjithë këtyre proceseve do të kemi vetëm një zyrë kadastrë me prona të regjistruara, të hedhura saktë, pra, jo me hartografinë e sotme, ku gjysma e halleve dalin vetëm për shkak të problemeve të hartografisë, dhe çdo pronë të ketë një emër, pra është e filanit. Pastaj, se mund ta ndjekin në gjyq për ta ndarë apo rindarë, kjo është tjetër gjë. Pra, të jetë e saktë, të jetë e regjistruar dhe të ketë një emër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Vazhdojmë me pyetje e diskutime nga kolegët, në lidhje me projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Ka kërkuar fjalën për pyetje kolegu Edmond Lekaj.

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Lame, për shpjegimet që na bëtë në lidhje me funksionimin dhe ngritjen e zyrave të reja dhe për punën e madhe që keni bërë në këtë proces, sepse e dimë të gjithë se është edhe merita juaj në hartimin e këtij projektligji.

Unë kam disa pyetje, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me pronësinë mbi tokën. E para: a mendoni se do të zgjidhet përfundimisht problemi i madh mbi pronësinë? Dinamika e pronave në Shqipëri është e ndryshme në zona të ndryshme të Shqipërisë. Unë kam parasysh këtu bregdetin, konkretisht Jugun e Shqipërisë, ku ka probleme shumë të mëdha. Kryesore është problematika e mbivendosjes së pronësisë. Si e keni menduar dhe kush do të ketë prioritet në këtë mbivendosje?

Pyetja e dytë është: a jeni konsultuar me grupet e interesit sa i takon kësaj nisme që keni ndërmarrë? Si do të jetë funksionimi i zyrave? Do të jetë në bazë bashkie, në bazë qarku? Si e keni menduar?

Pyetja tjetër lidhet me pronat shtetërore të paregjistruara. Çfarë do të bëhet me pronat shtetërore? Konkretisht, si konsiderohen pronat e sindikatave? A konsiderohen prona shtetërore? Çfarë zgjidhjeje do të ketë me pronat e sindikatave?

Pyetja tjetër lidhet me tokat bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të marra nga punonjësit që kanë qenë pjesë e atyre ndërmarrjeve gjatë sistemit të kaluar. Këto prona ndodhen brenda zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit. Si është menduar vendosja e vijës turistike? Vetëm në bashkinë e Vlorës, së cilës i referohem, janë rreth 700 familje që e kanë këtë

problematikë. A ka ndonjë mundësi ligjore, zoti lame, për ta rishikuar paligjshmërinë në gjithë këtë proces?

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët, që t’i marrë zoti Lame pyetjet? Sepse mund të ketë pyetje, të cilat janë të ngjashme në problematikë.

Nëse nuk ka, mund të vazhdoni me përgjigjet e pyetjeve të kolegut Leka.

Artan Lame – Problemet e tokës në Jug nuk janë thjesht probleme të tokës në Jug, por në njëfarë mënyre janë probleme të tokës mbi një kuotë të caktuar lartësie. Kjo do të thotë se përgjithësisht, ligji 7501 në fushë dhe deri në zonat kodrinore, të cilat kanë goxha tokë dhe i kanë të sistemuara gjatë viteve të komunizmit, përgjithësisht procesi ka avancuar dhe që është zbatuar ligji 7501. Në zonat malore, ku toka ka qenë e limituar, ndërhyrjet e shtetit për sistemimin, që të zhduken kufijtë e vjetër, kanë qenë më të limituara, problemet e zbatimit të ligjit 7501 janë shumë më të mëdha.

Probleme të tilla ka bregdeti i Jugut, probleme të tilla identike ka edhe Veriu i Shqipërisë, probleme të tilla kanë edhe fshatrat e thella të Tiranës. Prandaj them se më tepër është çështje kuote se sa çështje Veri-Jug.

Për këtë arsye, ne morëm në përgjithësi problematikën, sa i takon mënyrës se si do të trajtohet problemi aty ku është zbatuar ligji 7501 dhe aty ku nuk është zbatuar. Jemi nisur nga një parim i thjeshtë, që e kemi quajtur latinisht *accepta facta*, pranimi i faktit, që do të thotë se një fshatari që e ka marrë tokën më 1991, edhe po nuk qe e tija, më 2018 nuk ka kuptim t’i themi: jo, ligji ta ka dhënë atje më tutje! Hiqe këtë këtu! Ke njëzet vjet që e punon, që e ke të gjyshit me kujtesë, por nuk ke letra! Do të ta heqim këtë këtu, dhe do të shkosh patjetër atje ku e ke për ta marrë tokën!

Vërtetë që në këto njëzet e pesë vjet janë zvarritur problemet, por ka pasur vetëm një të mirë: në njëfarë mënyre, komunitetet brenda vetes janë sistemuar, që do të thotë se midis tyre, njëri është shtyrë këndeje, tjetri është shtyrë andej, ky e ka shtyrë më këndeje, kanë gjetur një vijë të mesme, ku janë ndarë. Dikush ka shkuar te toka e vet dhe ka thënë: shiko, merr ti te toka jote, pavarësisht së ligji ta ka dhënë këtu; le ta shkëmbejmë, se dua të shkoj te toka e pleqve, e kështu me radhë. Pra, njerëzit e kanë gjetur një lloj sistemimi me njëri tjetrin.

Në këtë pikë, është absurde që atje ku nuk është zbatuar, t'u themi njerëzve: ne do t'ju kthejmë me zor te 7501-shi. Ata, nëse e kanë respektuar tokën për frymë, aq sa u takonte me ligj, përveçse e kotë është edhe e pamundur t'i çojmë me zor te ligji 7501. Kjo na çoi te parimi që përmendëm, parimi i pranimi të faktit, pranimi i asaj që ka ndodhur në terren, duke respektuar sipërfaqen që i takonte për frymë, që të mos lejojmë që njëri të marrë dyfishin e saj që i takonte me 7501-shin, ndërsa tjetri të mos marrë asgjë, së pari duke respektuar sipërfaqen që i takon për frymë, dhe e dyta duke lënë ca shtigje për të plotësuar me tokë aty ku ka mundësi të plotësohet, ose ta paguajë pjesën që mund të ketë marrë më shumë.

Problemit të Jugut i shtohet një faktor tjetër, që Veriu nuk e ka. ka të bëjë me vlerën e shtuar që ka toka në Jug. Pra, në qoftë se tokat në Veri i kanë këto problematika dhe ata e kanë gjetur fjalën me njëri-tjetrin, nuk ka atë vlerë toka në Jug, ku për një mosmarrëveshje rrezikohet të shkohet në konflikte të rënda.

Problemi kryesor që ka penguar regjistrimin në Jug nuk ka qenë thjesht ky, por ka qenë paaftësia e shtetit për ta pajisur Jugun me hartografi të saktë. Duket i pabesueshëm fakti që janë investuar edhe disa projekte të huaja për regjistrimin e tokës në bregdetin e Jonit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Projekti i Bankës Botërore, projekti i OSBE-së, që ka investuar 500 mijë për regjistrimin fillestar në Jug, por që ka dështuar. Pra, problemi kryesor atje është mungesa hartografike dhe mungesa e regjistrimit. Për të shkuar më pas tek çështja: sa të takon e si të takon. Pra, kjo është kapja me themel, që është bërë te legjislacioni aktual.

Konsultimi me grupet e interesit. Në radhë të parë do të doja të qetësoja grupet e interesit, të lidhura me ish-pronarët. Nuk ka asnjë prekje, se është ngritur disa herë. Diku nga mosnjohja, diku nga keqdashja, është ngritur ideja sikur do të preket prapë legjislacioni për ish-pronarët. Nuk ka asnjë prekje negative të legjislacionit për pronën në lidhje me ish-pronarët. Përkundrazi, ka elemente pozitive, sepse ën fondin për ish-pronarët shkojnë edhe një pjesë e të ardhurave që do të krijohen nga shitja e parcelave të tokës që punohet nga ana e fermerëve prej një periudhe të gjatë. Pra, është shtimi i fondit të kompensimit për ish-pronarët. Praktikisht, është i panevojshëm konsultimi me ish-pronarët, sepse legjislacioni i tyre nuk preket fare. Madje kjo ishte edhe arsyeja që u la jashtë ATP-ja, pikërisht për të mos pasur probleme, për të mos krijuar sensibilitete të panevojshme.

Rrjeti i sotëm në terren ka 21 zyra të ALUIZNIT dhe 35 zyra të ZRPP-së. Ne tentojmë që të kemi 12 tru elektronikë në nivel qarku dhe 61 zyra shërbimi në secilën bashki, duke synuar që në çdo bashki të ketë zyra të trajtimit të qytetarëve, ndërsa regjistrat dhe sistemet elektronike të jenë të përqendruara në nivel qarku. E para, për ta çuar shërbimin sa më afër qytetarëve, pra në 61 bashkitë. Sot shërbimi i ZRPP-së është në 35 bashki. E dyta, për të përqendruar regjistrat, si ato elektronikë, ashtu edhe ata fizikë, në sa më pak zona, për t'i ruajtur nga çdo lloj dalldie, nga lloj-lloj momentesh, që ne i kemi adet ndonjëherë.

Në lidhje me pronat e sindikatave, ne e kemi lënë një nen aty, por e kemi përmendur si çështje. Detyrohem të them se do të jetë shumë shumë e vështirë, që shteti t'i kthejë vetes prona, të cilat sot trajtohen në mënyrë tërësisht abuzive, por është vetë shteti që nëpër vite ia ka prerë vetes gati çdo mundësi për t'i trajtuar pronat e sindikatave. Diku me vendime të Gjykatës së Lartë, diku me vendime të Gjykatës Kushtetuese, është hequr gati çdo mundësi për të prekur pronat e sindikatave, të cilat sot, për fat të keq, trajtohen në mënyrën më abuzive të mundshme.

Nuk më takon të bëj sugjerime në këtë fushë, por mbase bërja e një ligji të ri për sindikatat do të ishte zgjidhja edhe për mënyrën e trajtimit të tyre. Sepse sot nuk e dimë se kush i ka këto prona. I kanë ca njerëz, të cilët nuk i japin llogari askujt dhe të cilët nuk i ka zgjedhur askush, por megjithatë ata i japin, i shesin, i përdorin pa asnjë lloj kontrolli. Ligji për sindikatat është ai i 1992-shit, në mos gabohem. Nuk është amenduar e nuk është parë asnjëherë, kështu që vetë shteti ia ka prerë duart vetes për t'i kanalizuar. Megjithatë, si çështje është e përfshirë në ligj.

Tokat e ndërmarrjeve bujqësore në zonat turistike.

Ky është një problem shumë i ndjeshëm, që është hapur veçanërisht së fundmi gjatë vitit 2018, me dy vendime të qeverisë, që bënë një ngrirje të marrjes së akteve të AMTP-vë në zonën bregdetare. Ajo ngrirje u duk sikur penalizoi shumë njerëz, por, në kohë afatgjatë, rezultatin do ta ketë të mirë për shumicën e tyre, që do të thotë se VKM-ja 138, që pezulloi dhënien e AMTP-ve në bregdet, përpara një muaji u rishikua dhe u pajis me një hartë, e cila nga 1 km, zonën që pezullohej nga AMTP-të, e çoi në disa ishuj, të cilët janë ishujt e zhvillimeve strategjike brenda të cilëve nuk lejohet ndërtimi. Pra, nga një fashë njëkilometërshe u përqendrua, në mos gaboj, në rreth 60 pika (e ka bërë Ministria e Turizmit, prandaj nuk e di me saktësi numrin e tyre), brenda të cilave bllokohet çdolloj vendimmarrjeje pikërisht për arsye të potencialit të lartë turistik që kanë ata dhe gjithë fasha tjetër u çlirua.

Në ligjin e proceseve transitorë, megjithatë, ka një dispozitë që ndalon regjistrim e AMTP-ve në fashën ranore, sepse është absurde të themi ka qenë tokë bujqësore fasha e ngushtë ranore, flas për 100-metërshin e bregut dhe të gjithë jemi koshientë për denoncimet që janë bërë muajt e fundit për AMTP-të e dhëna në mënyrë tërësisht abuzive.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Urdhëroni, zoti Çyrbja!

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Lame, si keni menduar t’u jepni zgjidhje rasteve (ka shumë raste në qytetin e Durrësit, apo më saktë në njësinë administrative Rrashbull), ku gjatë azhurnimit që është i bërë regjistrimit fillestar të pronave, kompanitë që kanë bërë regjistrimin kanë krijuar shumë probleme dhe mbivendosje të paqena dhe qytetarët janë para faktit që, kur paraqiten në zyrën e regjistrimit, nuk u përputhet harta e zyrës së regjistrimit me axhornimin që ka bërë kompania private?

Këto raste janë pothuajse në 80% të njësisë administrative Rrashbull, raste të paregjistruara dhe me problematika të mëdha. Aktualisht, kur shkohet pranë zyrës së regjistrimit, kërkohet të bëhet një riazhurnim i parcelës, por gjatë riazhurnimit mund të kemi raste që prona ka pësuar transaksion (një nga pronarët ka bërë një shitje të pronës). Si do t’u japim zgjidhje këtyre rasteve?

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Lame!

Artan Lame – E nisim nga Rrashbulli, një komunë e rëndësishme e vendit, për ta shtrirë në të gjithë sipërfaqen, ku janë 2,8 milionë prona në vend të regjistruara me probleme, dmth Rrashbulli është pjesë e këtij 2,8-milionëshi. Thelbi i gabimit është se shteti shqiptar që nga ’94, kur ka filluar procesi i regjistrimit fillestar dhe deri në 2013-2014 ka shpenzuar të indetifikuara deri tani rreth 80 milionë euro për këtë proces, i cili, në vend që të zgjidhi hallin, ka krijuar halle mbi halle, se në fakt pronat e shqiptarëve nuk janë njëra mbi tjetrën, shtëpitë nuk janë njëra mbi tjetrën, por janë hartat që bën shteti dhe që duhej të ishin ato që ta saktësonin pronën, por ato kanë shkaktuar problematikë të mbivendosjeve.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veçanërisht vitin e fundit, ka bërë një punë të jashtëzakonshme për rishikimin e hartografisë, por kjo nuk është një çështje që zgjidhet

menjëherë. Kjo është një çështje që do të kërkojë, për fat të keq, vitet e veta. Ta themi hapur, ky proces do të kërkojë vitet e veta, sepse u deshën 25 vjet për ta regjistruar gabim Shqipërinë, prandaj do të duhen disa vjet për ta reregjistruar, duke hequr mbivendosjet.

Në bashkëpunim me hipotekën qeveria ka nxjerrë një VKM në vitin 2015 me të cilën u mundua të zgjidhë këtë ngërç absurd që ZRPP-ja ka harta me vlerë ligjore, por të pasakta, ALUIZNI kishte prodhuar harta të sakta, por pa vlerë ligjore (të sakta sepse ka rrjetin e punonjësve në terren që kishin bërë të gjitha matjet e Republikës). Për të zgjidhur këtë ngërç u bë një VKM në 2015-n që detyronte ZRPP-në që aty ku hartat e veta rezultojnë më problem, të përdorte hartografinë e prodhuar nga ALUIZNI. Ky është thelbi i asaj që do të ndodhë edhe në të ardhmen. Pra të bëhet një hartografi e saktë, jo më e një banese, të një personi që ankohet, dhe kjo ka të bëjë me kthimin e agjencisë në proaktive, por ta marrë të gjithë bllokun. Pra, në qoftë se në Rrashbull do të hyhet për një banesë sepse ka mbivendosje, atëherë do të merret i gjithë blloku që të ribëhet për të shkuar të gjitha gjërat në vend. Nuk është ndonjë shpikje që po e bëjmë ne, por është e vetmja rrugë për të rregulluar të gjithë hartografinë pastaj, në formë pazelli njërën pas tjetrës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Do t'ju lutem t'i jepni shumë shkurt përgjigjet, për arsye se kemi edhe ligjin tjetër për kadastrën, ndërkohë komisioni ka një aktivitet shumë të rëndësishëm në orën 12:15.

Ju lutem të gjithë kolegëve të fokusohen shkurtimisht për pyetjet dhe përgjigjet!

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka - Faleminderit!

Unë po i trajtoj të dyja projektligjet në një, sepse janë të lidhur me njëri-tjetrin. Është e vërtetë që pas kaq shumë vjetësh tranzicion dhe veprimtari administrative me titujt e pronësisë shihet si një hap shumë i mirë prezantimi i dy nismave ligjore që përcaktojnë themelin e reformës së pronës, një nga prioritetet e kësaj maxhorance, i cili, për mendimin tim, është i vonuar, duhej të ndodhte më parë.

Nga ana tjetër vlerësoj faktin që nisma vjen e mirëmenduar sa i takon analizës së problematikave të hasura gjatë funksionimit të punës së institucioneve, sepse në momentin që identifikohen problematikat është shumë më e lehtë dhe më e favorshme të gjenden edhe zgjidhjet.

Ajo që dua të theksoj, nga sa kam analizuar nga të dyja nismat, ka të bëjë pikërisht me faktin se ne jemi përpara dy nismave, të cilat synojnë të lehtësojnë dhe të unifikojnë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me regjistrimin e titujve të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, me

qëllim që të evitohet mbivendosjet e krijuara në terren dhe në harta dhe të dhëna të ndryshme, të cilat janë depozituar apo administrohen nga organe të ndryshme të administratës që merren me çështjet e pronësisë dhe që në praktikë kanë krijuar ngërçe dhe bllokime sa i takon zgjidhjes definitive të problemit real që kanë sot qytetarët. Pra, edhe nëse kanë një titull, nuk e kanë të përdorshëm, sepse njëra zyrë disponon të dhëna hartografike të tjera, njëra zyrë ka një hartë të ndryshme nga zyra e mëparshme dhe qytetari bën pingpong në zyrat e shtetit edhe pse disponon një dokument pronësie, ka një problem hartografie.

Problemet e hartografisë nuk rezultojnë sot siç e prezantoi edhe zoti Lame, vetëm në të dhënat që kanë institucionet, por edhe në mospërputhjet që kanë të dhënat e institucioneve me gjendjen faktike dhe situatën reale të pronave të qytetarëve.

Ky është një problem që shpeshherë në praktikë qytetarëve u kërkohet ta zgjidhin me plan rilevimi të vetin, ndërkohë që edhe plani i rilevimit që bën qytetari duke mos u përputhur me të dhënat që ka institucioni ngelet prapë një problem i pazgjidhur dhe përsëri qytetari endet detyrë të institucionit. Të mbarojë kjo praktikë. Duhet të jetë institucioni ai që e bën hartën, bën verifikimin në terrene të pronave, bën verifikimin e të dhënave që përmbajnë titujt e pronësisë dhe më pas duhet të japë zgjidhje për qytetarin.

Për ta qartësuar, titujt e pronësisë janë tituj të cilët i fiton qytetari qoftë ky person fizik-juridik apo shteti nëpërmjet mënyrave të ligjshme të fitimit të pronësisë që parashikohen në Kodin Civil. Zyrat e regjistrimit të pasurive deri më sot apo organet e tjera të shtetit apo zyra e re e kadastrës, që do të krijohet si një agjenci ku do të bashkohen kompetencat e zyrës aktuale të regjistrimit të pasurisë, me atë të legalizimit, do të jetë, gjithashtu, një organ administrativ, parimi kryesor i të cilit do të jetë verifikimi i titujve me qëllim regjistrimin dhe jo lëshimi i titujve të pronësisë, sepse kjo gjë duhet të jetë shumë e qartë për të gjithë dhe nuk duhet të ngatërrohet. Titujt e pronësisë janë tituj që jepen nga gjykata, prodhohen nëpërmjet transaksioneve mes palëve me vendim administrativ apo me akte të tjera të cilat parashikohen në Kodin Civil dhe detyrë e shtetit është që këta tituj të regjistruar apo jo, me probleme apo jo, të kenë garancitë që të regjistrohen ashtu siç e drejta i takon pronarit në zyrat e shtetit. Këtë e kanë si qëllim të dyja nismat, të dyja projektligjet.

Më vjen mirë që në projektligje shoh që në bazë të analizës së kryer janë trajtuar çështje të problematikave që ne i njohim sot, edhe pse jemi deputetë të zonave tona elektorale, edhe pse jemi vetë qytetarë dhe jemi përballur me problematika që kemi sa i takon regjistrimit të titujve,

por edhe nga fakti se shumë herë në këtë komision jemi ndeshur me problematika që na është dashur t'i zgjidhim për t'u dhënë të drejtë qytetarëve që ta marrin shpejt, pa pasur probleme të ecejakeve nëpër zyrat e shtetit dhe të ngelen pa zgjidhje për vite të tëra.

Kemi rekomandime nga institucionet ndërkombëtare, që merren me titujt e pronësisë, kështu që mënyra se si sillen të dyja nismat, mënyra se si janë konceptuar, qëllimi i nismave dhe mekanizmat në to, në gjykimin tim, për aq sa kam shqyrtuar sa i takon këtij shqyrtimi në parim, janë të sakta, të drejta, përkojnë me politikat qeverisëse për zgjidhjen një herë e mirë të problemeve me regjistrimin e titujve të pronësisë.

Nga ana tjetër, janë një garanci, e cila në kuadër të procesit të derregulimit, thjeshton procedurën se si qytetarët, se si organet e shtetit duhet të bëjnë regjistrimin e tyre dhe më vjen mirë që, sa i takon pjesës së trajtimit financiar të taksave të tarifave, ka rregulla të qarta dhe parime në mënyrë që të mos rëndojnë në xhepat e qytetarëve.

Është shumë e rëndësishme që në projektligjin "Për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë" trajtohen me radhë shumë çështje, shumë problematika që janë hasur. Unë do të doja të përmendja disa prej tyre, edhe për efekt opinionit publik, sepse në fund të fundit, qytetarët këtë do të duan të kuptojnë. Kemi qenë të gjithë këtu, kemi shtyrë afatin e regjistrimit të titujve, kemi vënë detyrime për bashkitë që të merren me këtë proces duke ua hequr barrën qytetarëve për plotësimin e akteve, duke thjeshtuar numrin e dokumenteve që qytetarët duhet të çojnë. Pra, duhet të jetë bashkia apo organet e tjera që duhet të vendosin dhe përsëri jemi para faktit që ky problem nuk është zgjidhur.

Ky problem gjen zgjidhje në këtë ligj, ashtu siç gjejnë zgjidhje edhe mospërputhjet mes të dhënave të institucioneve. Sa i takon hartografisë, gjithashtu gjen zgjidhje problemi i sipërfaqeve, që janë kaluar në pronësi pa shpërblim, gjen zgjidhje moria e problematikave për ndërtimet pa leje, ku nuk zgjidhet vetëm problemi i atyre që kanë ndërtuar pa leje në tokën e pronarit të ligjshëm, por edhe pronari i ligjshëm joposedues. Sot nuk kemi asnjë referencë ligjore të saktë se çfarë ndodh me ato ndërtime pa leje të cilat nuk janë tërësisht pa leje, por kanë shtesa. Sot kemi zgjidhje për ndërtime pa leje të cilat nuk kanë shtesa në volume, por nuk kemi zgjidhje ligjore për ndërtime pa leje që kanë edhe shtesa në volume, që edhe sikur t'i shembësh, është e pamundur ta realizosh pa shembur gjithë ndërtesën, ama kemi edhe probleme të tjera sociale të privatëve që mund të kenë përfituar të drejta pronësie në këto ndërtime. Pra gjen zgjidhje edhe ky problem.

Më vjen mirë që nuk preket e drejta e pronarëve, që është e njohur si e tillë me vendime të mëparshme të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por garantohej më shumë dhe jepen rregulla se si do të përfitohet kjo duke mbajtur në konsideratë edhe vendimet e Strasburgut.

Më në fund do të ketë një regjistër të integruar. 10 vjet është afati i ligjit deri sa të përfundojnë procedurat administrative në mënyrë që edhe pronat e shtetit, ashtu siç e thatë edhe ju, të regjistrohen. Pra me një regjistër të integruar të kadastrës çdo njeri mund ta dijë se kush është pronari i vërtetë dhe cilat janë pretendimet, pra çdo gjë do të jetë *online*. Qytetari mund të paraqitet vetëm me një kartë identiteti pranë zyrës përkatëse dhe të kërkojë informacion për pronat e tij pa pasur me vete as deklaratën noteriale dhe as vërtetim pronësie, gjë që qytetarët sot e vuajnë duke harxhuar ditë të tëra nga njëra zyrë te tjetra. Pra, kjo gjë evitohet vetëm me një kartë identiteti.

Gjithashtu, zgjidhen problemet e legalizimit në zonat turistike të stimuluar, për sa i takon pronësisë së truallit dhe pronësisë së ndërtesës dhe shumë probleme që kanë mbetur pezull nga ligjet e tjera, si për oborret në përdorim e të tjera.

Unë kam edhe disa konstatime, të cilat do t'i adresoj patjetër gjatë diskutimit nën për nën të projektligjeve.

E para, ne tashmë kemi një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, për sa u takon çështjeve që trajtohen në të dyja projektligjet, duhet të jemi të kujdesshëm që ta referojmë këtë, sepse kemi të bëjmë edhe me sigurimin e të drejtës, por edhe me faktin se praktika gjyqësore do të na bjerë ndesh nëse nuk e unifikojmë të njëjtën gjë me përmbajtjen e projektligjeve.

Çështja tjetër ka të bëjë me faktin se në dispozitat që i takon regjistrimit të titujve të pronësisë duhet bërë e qartë që zyrat që krijohen nuk japin tituj pronësie, por janë zyra që administrojnë regjistrat për tituj pronësie dhe saktësojnë të dhënat nisur nga dokumentet zyrtare dhe tituj të ligjshëm pronësie, që lëshohen nga organet përkatëse apo nga transaksionet mes palëve.

Gjatë shqyrtimit nën për nën duhet të qartësojmë edhe dispozitat kalimtare sesi do të kalojnë nga regjimi dhe çështjet aktuale që trajtohen sot nga organet që shkrihen me njëra-tjetrën, në regjimin e ri. Duhet t'i adresojmë me shumë kujdes çështjet të cilat janë të parashikuara në Kodin Civil dhe nuk duhet të bien ndesh me këto dy nisma, për arsye se nëse në zbatim do të jenë të pazbatueshme për sa kohë që do të prevalojë Kodi Civil. Duhet të kemi në konsideratë një parashikim në Kodin Civil, ku thuhet: “Regjistrin e kadastrës që mban Ministria e Drejtësisë”, sepse këtu kemi disa parashikime që nuk janë në përputhje me këtë.

Pra thashë dy, tre çështje të cilat mendoj që kanë shumë rëndësi të diskutohen gjatë shqyrtimit nën për nën të projektligjit. Pa hequr asnjë presje nga ato që thashë më përpara, kjo është një nga nismat më të mira të qeverisë, e cila i jep fund njëherë e mirë të gjithë tranzicionit me titujt e pronësisë dhe çdo njeri mund ta dijë se cila është prona e vet, e ka të përdorshme, e hedh në qarkullimin civil, fiton me pronën e tij, e zhvillon dhe bën çfarë të dojë pronari me të, por nuk ngelet kurrë peng i një veprimi administrativ, i cili nuk ia jep të drejtën ta qarkullojë lirisht në jetën shoqërore.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Relatorja e ezauroi relatimin për të dyja projektligjet, prandaj hapin diskutimin për projektligjin e parë “Për përfundimin e procesit kalimtar të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

Fjalën e ka kërkuar kolegu Alket Hyseni. Nëse keni diçka për të shtuar edhe për projektligjin e dytë, mund t’i ezauroni të dyja projektligjet.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Është e pashmangshme që t’i ndash diskutimet, pasi të dyja projektligjet vijnë si paketë dhe unë dua të ndalem në këtë moment, i cili nuk është një moment i zakonshëm ku ka ardhur një ligj i zakonshëm. Këtu jemi përpara reformës më të madhe dhe përpara revolucionit më të madh në fushën e pronësisë, që është bërë këta 28 vjet.

Gjej rastin të filloj diskutimin me falënderimin e grupit të punës, i cili ka qenë shumë i gjerë ku janë përfshirë një tërësi institucionesh dhe unë kam pasur kënaqësinë të konsultohem me ta vazhdimisht. Nuk ka qenë e lehtë, madje ka qenë shumë e vështirë, sepse ka pasur diskutime pa fund dhe do të ketë, por me krenari ky grup ka sjellë këtë paketë ligjesh, të cilat kanë dy dimensione.

E para, është dimensionimi politik. Ky ligj vjen me mbajtjen e premtimit të madh të fushatës së fundit elektorale, që ka bërë Kryeministri Edi Rama për zgjidhjen e problemit të pronësisë.

Po ashtu është një arritje e madhe në fokus të proceseve integruese.

Ne jemi të gjithë koshientë që në raportet e Bashkimit Europian theksohet se reforma e pronës ka qenë thembra e Akilit, në aspektin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, por edhe në aspektin e përgjithshëm të shtetbërjes dhe shtetformimit në Shqipëri.

Gjithashtu, vjen me risi në konceptin ekonomik dhe të tregut të lirë. Futja e këtyre kapitaleve të mëdha në tregun e lirë është një vlerë e madhe që i futet tregut në përgjithësi, duke

bërë të mundur që secili që disponon një pronë mund ta fusë në treg. Që nga fshatari apo kushdo tjetër, duke u ndjerë pronari, është më i përgjegjshëm për ta zhvilluar pronën i qetë dhe i lirë duke krijuar frytet për vete, familjen dhe për shoqërinë.

Është me risi në aspektin social, sepse zgjidh problematikat e pronësisë, eliminon një tërësi konfliktesh sociale dhe zbut drejtpërdrejt efektet e varfërisë, sidomos në zonat rurale ku prona është e vetmja mundësi e jetesës së atyre familjeve.

Për sa i takon dimensionit juridik, sot kemi dy projektligje të rëndësishme, të cilat marrin përsipër atë që nuk e merrte askush në këto vite që kanë kaluar, duke zgjidhur një tërësi ngërçesh, problematikash dhe vakumesh ligjore, që janë krijuar diku me qëllim, diku pa qëllim, diku nga pikëpamja rutinore e procedurave administrative dhe diku tjetër duke involvuar në mënyrë kriminale institucione të tëra shtetërore, deri te gjykatat, duke sjellë këtë situatë, prandaj me patjetër kërkohej kjo ndërhyrje ligjore.

A i zgjidhim të gjitha problemet? Unë mendoj se zgjidhim një tërësi problematikash, por edhe gjatë diskutimit nen për nen mund të shtojmë edhe ndonjë gjë tjetër që mund të ketë ngelur pa u diskutuar. Prandaj të gjithë kolegët dhe kushdo që ka dëshirë të kontribuojë apo ka njohuri për këtë proces, mund të na furnizojë këto ditë me informacione, problematika, me propozime dhe sugjerime për zgjidhjen e tyre.

Ka situata, të cilat duhen pasur parasysh, për shembull, rastet e vendimeve të Këshillit të Ministrave të dhëna në situata specifike për shpronësime apo kompensime të ndryshme, për rastet e ndërtimit të veprave publike dhe zhvendosjen e fshatrave të tërë, të cilat edhe pse jemi përpjekur t'i japim një zgjidhje, unë mendoj që duhet t'i rishikojmë në këtë ligj. Mund t'ju jap një shembull konkret: ka qenë situata e zhvendosjes së një fshati në zonën e Konispolit, ku është ndërtuar një ujëmbledhës shumë i madh, dhe për kompensim janë dhënë troje për të ndërtuar shtëpi në Bertenesh. Kjo situatë jo vetëm që nuk është zgjidhur prej vitesh, por ka sjellë humbjen e seriozitetit të shtetit, për të mos folur për parimet juridike, sigurisë juridike e të tjera.

Prandaj, këto ditë të mbetura mund të gjejmë ndonjë situatë shtesë për ta futur në këtë ligj dhe për t'u hapur dritaren e mundshme ligjore akteve të mëparshme të Këshillit të Ministrave, të cilat do të kompletojnë bazën ligjore.

Si deputet i zonës së Sarandës, kam kënaqësinë t'ju falënderoj për punën e bërë, por edhe si iniciator i zgjidhjes së situatës për trojet e dhëna nga këshillat bashkiakë, këshillat komunalë dhe këshillat e rretheve, sepse ka qenë një gangrenë ndër vite dhe ka pasur një betejë të madhe mes

zyrave të regjistrimit që lëshonin tituj nga njëra anë dhe strukturave të tjera kontrolluese, siç ka qenë Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili nuk lejonte regjistrimin e këtyre titujve, kjo për shkak të vakumit ligjor, por edhe për shkak të interpretimit dhe këndvështrimit të ndryshëm që i bëhej këtij problemi. Sot këto problematika do t'i zgjidhë ky ligj, i cili është gati edhe me aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave, pra, që të mos nxjerrim ligje dhe të presim vite të tëra nxjerrjen e akteve për implementim, por sapo ligji të hyjë në fuqi të miratohen edhe aktet e Këshillit të Ministrave, në mënyrë që ligji të bëhen eficient dhe këto reforma të mëdha të ecin përpara.

Këto ndryshime nuk shoqërohen vetëm me revolucion ligjor, por edhe me revolucion strukturor. Për herë të parë është bërë një ndërhyrje e madhe në strukturat e shtetit, duke hequr strukturat që nuk konvergonin me njëra-tjetrën, për të mos thënë që pengonin njëra-tjetrën. Këtu është dëshmitar vetë drejtori Lame, për punën e madhe që është bërë për ta sjellë deri këtu, sepse ka pasur problematika të mëdha të hasura rrugës, ku institucionet, edhe pse janë të njëjtit shtet, edhe pse kanë të njëjtin qëllim ligjor dhe fokus të reformave politike, me ose padashje pengonin njëri-tjetrin. Në përgjithësi bëhej në mënyrë instiktive procedurale, por në raste të caktuara edhe për konflikte institucionale, prandaj ishte e nevojshme bërja e kësaj strukture të re. Por edhe pse mund të ketë skepticizëm, edhe pse mund të ketë specialistë të ndryshëm, të cilët kanë rezerva, unë mendoj që kjo duhet parë në fokus të zgjidhjes së madhe dhe të atij rezultatit të madh që do të sjellë shuarjen e tërësisë së problematikave të krijuara ndër vite.

Të nderuar kolegë të komisionit,

Të nderuar përfaqësues të qeverisë që keni sjellë ligjin,

Unë ju paralajmëroj që jeni përpara një betejë shumë të madhe, e cila nuk do të kalojë në heshtje nga aktorë apo faktorë që në vite kanë përfituar nga ky lëmsh i madh i krijuar prej tyre, të cilët do të ndihen të kërcënuar nga kjo paketë ligjore dhe nga kjo reformë e madhe strukturore.

Unë kam pasur kënaqësi dhe nderin të isha kryetari i Task Forcës së Kryeministrit për pronat në bregdet, ku kemi konstatuar problematika shumë të mëdha, të cilat ishte e pamundur të zgjidheshin të gjitha, por i kemi adresuar në organet e drejtësisë dhe në institucione shtetërore aq sa na lejohej.

Tashmë jemi të bindur që në këtë paketë ligjore, por sidomos edhe me reformën e madhe në drejtësi, e cila do të pastrojë gjykatën dhe prokurorinë, jemi të bindur që miliona metra katrorë do t'i rikthehen shtetit dhe shteti mund t'i përdorë edhe në funksion të proceseve kompensuese, por edhe në funksion të zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë së vendit.

Një gjë duhet ta kenë të qartë të gjithë ata që kanë përfituar në vite, që nuk do të kenë asnjë mundësi për të na penguar në këtë rrugë, nuk do të mund të hedhin baltë ndaj çdo nëpunësi shteti që përpiqet të bëjë detyrën e tij në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën dhe nuk do të ketë koçan apo kopan që duan të përfitojnë me dhjetëra hektarë me pa të drejtë. Prandaj ju paralajmëroj të jeni të durueshëm, sepse do të keni presione. Por do të keni mbështetjen maksimale të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të qeverisë që është aktori më i interesuar, por edhe opinionioni publik është në mbështetje të kësaj reforme, pra të gjithë së bashku ne do t'ia dalim të realizojmë këtë reformë të madhe.

Më lejoni të bëj edhe një sqarim për zonat e mia elektorale lidhur me vendimin nr. 708 të Këshillit të Ministrave, për të cilin qarqe të caktuara janë përprjekur të përhapin klimën që qeveria po ua merr pronat për t'ua dhënë oligarkëve e të tjera. Këto dezinformime nuk janë të rastësishme, por prapa tyre mund të kenë edhe interesa nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Unë jam i detyruar që nga pikëpamja teknike dhe politike të sqaroj se asnjë pronë me titull pronësie nuk përfshihet në këtë VKM, madje nuk përfshihen as pronat që janë në proces. Pra kushdo që siguron një titull pronësie është i lirë ta gëzojë pronën e tij. Qëllimi i vetëm i kësaj VKM-je ka qenë mbrojtja e këtyre pronave, të cilat në përgjithësi janë zona ranore dhe pyje, pra janë larg zonave të banuara dhe nuk janë prona të përfituara me ligjin nr. 7501. Pra nuk e involvojnë fare procesin e ligjit nr. 7501 apo të ligjeve të tjera që e kanë dhënë tokën e ndërmarrjeve bujqësore. Është i rëndësishëm, sepse ka krijuar një situatë shumë interesante në zonë, zoti kryetar.

Të gjithë banorët e Lukovës, Borshit, por edhe më gjerë, të Himarës, Dhërmiut, të jenë të qetë. Pronat që kanë marrë në përputhje me ligjin, pronat që kanë marrë me tapi, do t'i regjistrojnë falë këtyre ligjeve që do të bëhen tani dhe nuk ua prek askush. Nga ana tjetër, të gjitha ato prona, që janë të mundshme për zhvillim, që janë pa tituj, do të vihen në dispozicion të shtetit, për t'i zhvilluar apo për t'i pasur në fondin e tokës për kthimin dhe kompensimin e pronave.

Faleminderit dhe suksese në këtë proces!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Braho e ka fjalën për diskutim.

Spartak Braho – Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dyshim, pa u zgjatur shumë, mbështes plotësisht dhe veçanërisht mendimet dhe përfundimet e relatores, zonjës Bushka.

Unë nuk kam për të lavdëruar njeri, as qeverinë, as të gjitha strukturat që janë marrë me problematikën e tokës.

Me sa duket erdhi koha që ky problem i madh të pësojë reformim, të gjejë vendin dhe të normohet ligjërisht, ashtu siç duhet.

Çdo qeveri gjatë këtyre 28 vjetëve ka bërë çfarë ka dashur. Rotacioni sjell ndryshimin e qeverive dhe ne duhet të miratojmë një ligj që të mos ndryshojë, por të jetë jetëgjatë. Ky është kodi i tokës. Them kodi i tokës, në kuptimin e rëndësisë që ka, e një ligj që nuk duhet të ndryshojë më, ashtu siç janë edhe kodet që kërkojnë 3/5-at për t'u ndryshuar.

Gjithsesi, nga pikëpamja kushtetuese ne nuk e realizojmë këtë gjë, por mendoj se të dy projektet kanë nevojë të ripunohen, madje kanë nevojë të ripunohen thellë.

Nuk do të ndalem gjatë, por kam përshtypjen se me gjithë paraqitjen dinjitoze që i bëri zoti Lame, procesi i konsultimit nuk është realizuar ashtu siç duhet. Nuk kam ndonjë informacion të detajuar, por e shoh si domosdoshmëri procesin e konsultimit me shoqatat, me institucionet ndërkombëtare, në mënyrë nominale.

Ligji është parashikuar të hyjë në fuqi në datën 31 janar të vitit 2019. Në praktikë ky ligj nuk ka nevojë për kolaudim. Ky ligj do të verifikohet. Nuk kemi... Ose e kolaudojmë tani dhe e bëjmë gati për zbatim...

Prandaj, mendimi im është që, përballë batërdisë që është bërë nga zyrat e regjistrimit të pasurisë (ju e dini të gjithë, në përgjithësi këto zyra kanë qenë dhe mbeten çerdhe korrupsioni, përfshirë edhe gjykatat), duhet të jemi të kujdesshëm për ta riparë me vëmendje ligjin, ashtu siç edhe u propozua, me qëllim që të nxjerrim një ligj që t'i rezistojë kohës. Praktika e zbatimit të ligjit në të ardhmen do të jetë, si të thuash, treguesi që nuk do të na fusë në shtimin e problematikës, por në zgjidhjen e çështjes së madhe të ndarjes së tokës së pronësisë në Shqipëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Lame, do të shtoni diçka për ligjin për kadastrën, përpara se t'i hedhim në votim në parim të dyja ligjet?

Spartak Braho – Më fal, se kam edhe diçka tjetër!

Ulsi Manja – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Do të më falësh...

Duke i parë të dyja ligjet më shkoi mendja të pyes: pse nuk i bashkojmë të dyja ligjet?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Lame, përpara se të shkojmë në votim, a keni diçka të fundit për të shtuar për projektligjin “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”?

Artan Lame –Së pari, thelbi i asaj që duhet të bëjë të veçantë ligji për kadastrën është përmirësimi i përditësimit të pronave të regjistruara me probleme, dhe, së dyti, përfundimi i regjistrimit fillestar në Republikën e Shqipërisë.

Pjesa tjetër e legjislacionit është pjesërisht... Le të themi se ligji për kadastrën është legjislacion ndërkombëtar, në përshtatje me direktivat e kështu me radhë, si dhe konkluzionet e arritura nga ligji ekzistues për ZRVP-në, ligji që është edhe sot në fuqi.

Ajo që kadastra do të bëjë themelisht ndryshe është përfundimi i procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe përmirësimi i rreth 80% të pronave të regjistruara me probleme.

Në projektin fillestar ne kemi paraqitur dy opsione: një opsion ku të gjitha agjencitë mbeteshin atje ku ishin dhe për secilën rregullohej ligji, si dhe një opsion ku të gjitha ligjet përmbledheshin në një ligj të vetëm, ku ishte edhe ligji për kadastrën. Më pas i ndamë në dy ligje, për një arsye shumë të thjeshtë: Republika e Shqipërisë do të ketë kadastrë edhe pas 100 vjetësh, pra ligji për kadastrën edhe pas 100 vjetësh do të jetë ky. Ligji për kadastrën mund të ndryshojë, mund të jetë një ligj komplet i ri, por do të jetë edhe pas 100 vjetësh. Ligj për procese tranzitore nuk do të ketë më. Pra, ky ligj në një moment të caktuar, hap pas hapi, do të bjerë në shuarje, ndërsa ky do të jetë një ligj i përhershëm. Kjo ishte edhe arsyeja pse i ndamë në dy ligje.

Kam diçka të fundit për projektet e zotit Braçe. Natyrisht, që ditën e parë i kemi pasur, i morëm përmes jush dhe i pamë dy draftet në raport me draftin tonë.

Në qoftë se zoti Braçe kërkon thjeshtim procedurash për disa *nike* të caktuara brenda zonës së tij, ne i heqim fare ato procedura. Kështu që praktikisht, ato treten brenda masës së përgjithshme dhe gjejnë zgjidhje.

Projekti i zotit Braçe, me shumë të drejtë, përpiquej të rregullonte një fashë të caktuar, që nuk kishte gjetur zgjidhje, duke ndjekur përsëri skemën e vjetër, që të ndryshojmë pak procedurën, që të përfshihen edhe këta, në një kohë kur ne për të gjithë masën e thjeshtojmë procedurën. Kështu që automatikisht ato përfshihen dhe gjejnë zgjidhje.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Lame!

Përpara se t'i hedh në votim në parim, kam edhe unë dy fjalë për këto dy projektligje.

Në fakt, bashkohem plotësisht me mendimin e kolegut Braho, që vendimmarrjet e mëdha politike i dikton koha.

Ndoshta ka ardhur momenti që më në fund t'i jepet zgjidhje përfundimtare procesit kalimtar të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. Kur e them këtë, kam në mendje kalvarin e gjatë 28-vjeçar, mundin e stërmundimin e madh të qytetarëve shqiptarë për të vetmen gjë të shtrenjtë që ka njeriu në jetë: pronën e tij.

Mendoj se ky projektligj vjen në momentin dhe në kohën e duhur, edhe pse nga kolegët këtu u theksua se problematika do të ketë vazhdimisht.

Mua më mjafton fakti që zoti Lame tha se Shqipëria ka 4,4 milionë pasuri të paregjistruara, si dhe fakti tjetër që shteti ka regjistruar vetëm 4% të pronave të veta, që kryesisht i përkasin kohës së mbretërisë, për të kuptuar se çfarë ka ndodhur me pronat në Shqipëri, ku vetë shteti nuk ka qenë në gjendje të kujdesej për pronën e tij, por e ka lënë atë të bëhet lëmsh me vendime gjykatash apo tituj pronësie të prodhuara nga organet administrative, që të them: po, ky është momenti për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike, edhe pse jam dakord me atë që tha njëri nga kolegët e mi këtu, që pronat janë tjetërsuar dorë mbas dore dhe është e vështirë që disa lëmshe apo nyje gordiane që janë krijuar të priten me këto dy ligje.

Ligjin për kadastrën me vjen mirë që më në fund do ta kemi dhe do të jetë unik. Uroj që ky ligj t'i rezistojë kohës!

Ftoj kolegët e mi deputetë që gjatë këtyre ditëve të diskutimit nen për nen ta pasurojmë ligjin për kadastrën. Çfarë është kadastra në fund të fundit? Kadastra është regjistër publik i pronave të qytetarëve shqiptarë dhe shtetit. Kadastra do të jetë një regjistër publik i pasurive kombëtare të këtij vendi dhe shpresoj që ligji për kadastrën t'i japë fund një herë e mirë burokracisë së qytetarëve shqiptarë në sportelet e hipotekave të tanishme. Kam përshtypjen se kur dëgjojnë fjalën hipotekë, qytetarëve shqiptarë u dridhen leqet e këmbëve.

Shpresoj që ky ligj t'i adresojë këto problematika, të thjeshtojë burokracinë dhe t'u lehtësojë jetën qytetarëve shqiptarë, për të vetmen arsye: për të regjistruar pronën e tyre. Në fund të fundit, duhet të jetë interesi i shtetit t'i rrijë *pronto* qytetarit për të regjistruar pronën, sepse pronari, nëse e ka marrë pronën me një nga mënyrat e fitimit të pronësisë sipas Kodit Civil, mund të mos jetë shumë i interesuar për ta regjistruar. Duhet të jetë interesi i shtetit për të regjistruar pronat e qytetarëve shqiptarë, sepse me kadastrën lidhen edhe detyrime të tjera që kanë qytetarët ndaj shtetit.

Duke ju falënderuar për gjithë këtë diskutim konstruktiv që patëm sot për këto dy projektligje të rëndësishme, ftoj kolegët, por edhe përfaqësuesit e qeverisë, të investojnë në një punë aktive gjatë këtyre ditëve, që edhe problematikën që ngriti relatorja, kolegu Leka, Çyrbja, Braho, por edhe zoti Hyseni, t'i adresojmë në këto dy projektligje për të përmirësuar cilësinë e tyre, për ta bërë sa më të lehtë zbatimin e tyre nesër në praktikë për ato agjenci që do të punojnë me to!

Edhe një herë, faleminderit!

Kalojmë te votimi në parim i këtyre projektligjeve.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Kalojmë te votimi në parim i projektligjit të dytë, projektligji “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji për kadastrën.

Me parimin e këtij projektligji në parim, e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Shqyrtimi dhe miratimi nën për nën i këtyre dy projektligjeve do të bëhet javën e ardhshme. Rendi i ditës së mbledhjes do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

